



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

VENDIM
Nr. 550, Datë 04.10.2018

“Për dhënien e rekomandimeve për Kodin e Rrjetit mbi Rregullat e Ndërveprimit dhe Shkëmbimit të të Dhënave, propozuar nga operatori i kombinuar i gazit natyror Albgaz SHA”.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Z. Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj. Leida MATJA	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 04.10.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Mbi vlerësimin e procedurës për miratimin e Kodin e Rrjetit mbi Rregullat e Ndërveprimit dhe Shkëmbimit të të Dhënave, propozuar nga operatori i kombinuar i gazit natyror Albgaz SHA” nga ERE.

Bazë ligjore: Neni 24, shkronja d dhe f, neni 69 dhe 70 i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës “Mbi vlerësimin e procedurës për miratimin e Kodin e Rrjetit mbi Rregullat e Ndërveprimit dhe Shkëmbimit të të Dhënave, propozuar nga operatori i kombinuar i gazit natyror Albgaz SHA” nga ERE”;

VËREN SE:

Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, bazuar në nenin 69 dhe 70 të ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, realizoi vlerësimin e procedurës për miratimin e Kodin e Rrjetit mbi Rregullat e Ndërveprimit dhe Shkëmbimit të të Dhënave, propozuar nga operatori i kombinuar i gazit natyror Albgaz SHA” të nisur nga Bordi i ERE me vendimin nr. 197, datë 03.09.2018.

Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror “Albgaz” SHA, ka adaptuar/përshtatur Kodin -e Rrjetit mbi Rregullat e Ndërveprimit dhe Shkëmbimit të të Dhënave, i cili do të do të shqyrtohet dhe miratohet nga ERE.

Kjo Rregullore themelon një kod të rrjetit që specifikon rregullat mbi ndërveprimin dhe shkëmbimin e të dhënave si dhe rregulla të harmonizuara për aktivitetin e sistemeve të transmetimit të gazit dhe zbatohet për pikat e interkonjeksionit midis Palëve Kontraktuese në Komunitetin e Energjisë.

Duke qënë se Operatorit të Kombinuar të Gazit Natyror “Albgaz” SHA i lind e drejta për të aplikuar për shqyrtimin dhe miratimin e këtij Kodi pasi: Shoqëria “Albgaz” SHA, është e licencuar në aktivitetin e Transmetimit të dhe Shpërndarjes së Gazit Natyror; Është certifikuar Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror “Albgaz” SHA, në përputhje me nenet 37, 59, 68, dhe 80 të Ligjit Nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror” dhe nenit 9, pika 6, të Direktivës 73/2009 të Komunitetit të Energjisë (EC); “Albgaz” SHA, gëzon statusin e vëzhguesit pranë ENTSO-G, Rrjetit European të Operatorëve të Transmetimit të Gazit Natyror.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24 shkronja d dhe f, nenin 69 dhe 70, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. T’i rekomandojë Entit Rregullator të Energjisë që Kodi i Rrjetit mbi Rregullat e Ndërveprimit dhe Shkëmbimit të të Dhënave, propozuar nga operatori i kombinuar i gazit natyror Albgaz SHA të transpozohet pa ndryshuar tekstin apo strukturën e tij sipas parashikimeve të Vendimit nr. 2018/02/PHLG-EnC, datë 12.01.2018 të Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë të Komunitetit të Energjisë dhe Rregullores së Bashkimit European (BE) nr. 715/2009.
2. ERE të informojë Autoritetin e Konkurrencës mbi zbatimin e këtij rekomandimi sipas pikës 1 brenda 90 ditësh.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS